LAJME / KOSOVË

Vrasja e dyfishtë në Pejë, konflikti dyshohet se ndodhi pas një zënke mes viktimave

3 komente



08.09.2021 • 20:13

Një vrasje e dyfishtë ka ndodhur sonte në qytetin e Pejës, ku të vrarë kanë mbetur Astrit Ademaj, kandidat i PDK-së për kryetar të Pejës dhe Blerand Kadrijaj, zyrtar i lartë i kësaj partie.

Zëdhënësi i Policisë së Kosovës për Rajonin e Pejës, Fadil Gashi, ka konfirmuar për Telegrafin, se të shtënat me armë zjarri janë dëgjuar rreth orës 20:20 në afërsi të shkollës Ekonomike "Ali Hadri", ku dy persona kanë mbetur të vdekur dhe një tjetër i plagosur.

Ndërkohë, sipas informatave të para dyshohet se rasti ka ndodhur në një lokal në Pejë, ku viktimat fillimisht kanë pasur një konflikt mes vete, dhe më pas janë gjuajtur me armë zjarri. I plagosur ka mbetur edhe vëllai i Astrit Ademaj.

Në vendin e ngjarjes janë tashmë Policia dhe Prokuroria, e po ashtu aty kanë filluar të shkojnë edhe familjarët e Astrit Ademajt. **/Telegrafi/**



Policia e Kosovës | Vrasje në Pejë

ACN, asortiment i produkteve shtëpiake!
Sponzorizuar
Lexo më shumë

ONLINE Rent a Car, dedikoja vetes një udhëtim me veturën e ëndrrave!
Sponzorizuar
Lexo më shumë

Lajme | Telegrafi
Më të lexuarat në Lajme

Gjinekologët e Kosovës: Shtatzënat, gjidhënëset dhe ato që planifikojnë shtatzëninë të vaksinohen me vaksina të...

Lindita Nikolla zgjedhet kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Çfarë janë vaksinat me teknologjinë mRNA të cilat po rekomandohen nga ekspertët në Kosovë për gratë shtatzëna?

Bislimi thotë se iu keqinterpretuan deklaratat: Dokumentet rreth UÇK-së janë në arkiv të Kosovës, kanë qenë gjithmonë t...

TELEGRAFI sh.p.k.
Rr. Rexhep Mala, Aktash, Nr.34, Prishtinë, Kosovë
info@telegrafi.com 038 224 093 - +383 48 222 355

Ky portal mirëmbahet nga kompania "Telegrafi". Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Telegrafit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Partnerët
Dukagjini | DW | Shkabaj | Tosk e gegë

Lajme Ekonomi Sport Magazina Femra
Stili Shendetesia Teknologji Auto Fun
Radio Dukagjini Smard Telegrafi Jobs Marketing Arkiva
Për ne Prokurimi i hapur Privacy policy

Na ndiqni:
Available on the App Store | GET IT ON Google Play

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2006-2021 Portali Telegrafi